



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË –KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË ,KOSOVO POLJE

Nr. 132/23

Në mbështetje të Ligjit për Arsimin Para universitar në Komunitet të Republikës së Kosovës, Nr. 04/L-032, UA Nr.10/2018,UA 1512020, nenit 4.5 dhe 6 paragrafi 1,2 të Ligjit të Punës Nr.03/L212, neni 67 i ligjit për zyrtarët publik nr. 06 L-114 , UA Nr. 07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, lidhur me kushtet dhe kriteret për themelimin e marrëdhënies së punës ,Drejtori i Drejtorisë për Arsim në Fushe Kosove me datë 20.03.2023 shpalle :

K O N K U R S

Për themelimin e marrëdhënies së punës me afat të caktuar :

1.Titulli i vendit të punës : Zyrtar Publik

Titulli i punës : Drejtor i Institucionit Parashkollor

Orari i plotë i punës : 40 h në javë

Vendi i punës : IP Fushë Kosovë

Raporton tek : Drejtori i DKA-së.

Mandati : 4 vjeçar

Pozita të lira : 1

Koeficienti :E14 - 6.2

Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit të IP :

1.Drejtori/esha ka përgjegjësi ekzekutive në menaxhimin dhe administrimin e përgjithshëm të institucionit ,duke përfshirë :

1.1Pergatitjen e planit vjetor ,planit zhvillimor të institucionit edukativo-arsimor dhe raportet vjetore të punës ;

1.2 Përdorimin efikas dhe efektiv të sistemit për menaxhimin e informatave në arsim dhe respektimin e kodeve të këtij sistemi ,procedurave të sigurimit dhe afateve të përcaktuara për përditësimin e të dhënave të nevojshme gjatë vitit ;

1.3 Detyrat e caktuara për zgjedhjen e edukatoreve, vlerësimin ,disiplinën ne institucionin edukativo-arsimor dhe çështjet tjera qe kane te bëjnë me edukatorët dhe punëtorët tjerë te institucionit;

1.4 Mbështetjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit te plan programit ;

1.5 Mbështetjen dhe mbikëqyrjen e punës se aktiveve dhe bashkëpunëtorëve profesional te institucionit edukativo-arsimor , si dhe mekanizmave tjerë te institucionit edukativ qe kane rol ne vlerësimin e performancës se institucionit dhe menaxhimin e cilësisë se punës se institucionit;

1.6 Bashkëpunon me Këshillin drejtues te institucionit edukativo-arsimor (KD),Këshillin e Prindërve dhe komunitetin e institucionit edukativ ;

1.7 Raporton se paku dy here ne vit para KD;

1.8 Siguron ambient te sigurt dhe përkrahës për fëmijët ne institucionin edukativo-arsimor.

1.9 Ruajtjen e dokumenteve dhe te dhënave ,siç parashihet nga komuna apo Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH);

1.10 Çështjet e tjera qe rregullohen përmes ligjit për arsim para universitar, akteve nënligjore te miratuara nga MASH dhe obligimet qe dalin nga rregullorja e komunës për arsim.

2. Kushtet e konkurrimit:

Kandidatet e interesuar për te konkurruar për pozitën për drejtore duhet t'i plotësojnë këto kushte:

I. Të jene shtetas te Republikës se Kosovës ;

2.Te kenë te kryer arsimin universitar. Nivelet e kualifikimit qe i plotësojnë kushtet sipas normativit profesional për arsim te përgjithshëm dhe normativit për arsim profesional ne fuqi

2.II.Master për udhëheqje ,administrim ose menaxhim ne arsim(kualifikimin prej 300 ECTS, se paku 5 vite te shkollimit universitar);

I.2.2Master arsimor(kualifikimin prej 300 ECTS, se paku 5 vite te shkollimit universitar);

1.2.3 Katërvjeçar kualifikimin prej 240 ECTS, 4 vite te shkollimit universitar);

1.2.4 Bachelor katërvjeçar kualifikimin prej 240 ECTS, 4 vite te shkollimit universitar);

I.3.Te kenë licence te rregullt te mësimdhënësit sipas udhëzimit për licencim te mësimdhënësit.

1.4.Te kenë përfunduar me sukses një program kualifikimi profesional për Udhëheqje ,Administrim ose menaxhim ne arsim te bazuar ne standardet e praktikës profesionale për drejtor te shkollave ne Kosove të aprovuar nga MASH sipas

rekomandimit te KSHLM;

1.5 Te kenë përvojë pune ne procesin edukativo-arsimor sipas udhëzimeve te përcaktuara ne katalogun e punës 4,vjet përvojë pune për drejtore dhe 3 vjet përvojë pune për zëvendësdrejtore për arsimin fillor te mesëm te ulet.

Kandidatët konkurrues duhet te posedojnë këto dokumente:

1. Diplomën e fakultetit te kryer për nivelin përkatës te kualifikimit;
2. Certifikatën për kryerjen me sukses te programit te trajnimit për udhëheqje ,administrim ose menaxhim ne arsim te bazuar ne standardet e praktikës profesionale për drejtor te shkollave ne Kosove;
3. Kandidati ose kandidatja qe ka përfunduar programin universitar Master për udhëheqje administrim ose menaxhim ne arsim ne mungese te certifikatës se trajnimit për udhëheqje arsimore ,ofron dëshminë e diplomës Maste ne këtë fushe te studimeve;
4. Kopjen e dokumentit te identitetit(ID)
5. Certifikatën shëndetësorë te lëshuar ne gjashte muajt e fundit nga një institucion licencuar shëndetësor me te cilën dëshmohet gjendja e tij, e saj shëndetësore;
6. Dëshminë se nuk është nen hetime dhe dëshminë se nuk ka qene i.e dënuar për krim dhune ose vepra te padenja qe përfshijnë fëmijët
7. Dëshminë për përvojën e punës ne procesin edukativo-arsimor;
8. Deklaratën ne betim qe vërteton se ne tri vitet e fundit kandidati, kandidatja nuk ka qene ne asnjë funksion udhëheqës ne strukturat e partive politike.
9. Portofolin profesionale me dëshmi sipas udhëzimeve ne shtojcën e formularit H, te UA 151/2020 nga MASH. (PLANIN E PUNES).
10. Dokumentacioni për konkurrim dorëzohet ne një kopje fizike ne zyrën pritëse sipas afatit te konkursit te publikuar.

Konkursi mbetet i hapur 15 dite nga dita e publikimit, nga data 21.03.2023 deri me 04.04.2023.

